

Dr. Iljaz Rexha

SHTRIRJA E VENDBANIMEVE MESJETARE MBI BAZËN E ETNONIMIT ARBAN - ALBAN NË BALLKAN

Lidhur me shtrirjen e vendbanimeve mesjetare shqiptare në mesjetë për periudhën nga shek. XIII-XV janë shkruar shumë artikuj dhe studime, si nga studiues të huaj ashtu edhe shqiptarë. Mirëpo, deri më tani nuk është botuar asnjë material arkivor e onomastik në të cilin në hapësirën e Ballkanit dalin të dëshmuara vendbanimet mesjetare mbi bazën e etnonimit – emrit popullor *Arban*, që dëshmojnë shtrirjen e tyre jo vetëm në aspektin etnolingistik, por edhe në atë etnogeografik.

Në historiografinë e popujve sllavë edhe më tej vazhdoi të zotërojë teza e L. Thaloçit dhe K. Jireçekut, me origjinë çeke, e parashtruar që në vitin 1899 dhe e riformuluar më hollësisht në vitin 1913 nga bashkëkohësi i tyre Milan Shuflaj, me origjinë kroate. Këta u morën me historinë e popujve sllavë në mesjetë e sipërfaqësisht edhe me historinë e popullit shqiptar. Në mungesë të lëndës arkivore dhe të burimeve historike të dorës së parë, sidomos të regjistrave kadastralë të administratës së Perandorisë Osmane, ata nxorën përfundimin e gabuar dhe kufijtë etnogeografikë të Arbanonit mesjetar në shekujt e sipërpërmendur në bazë të dokumenteve që njiheshin deri atëherë i përkufizuan për afërsisht në katërkëndshin e ashtuquajtur Tivar-Prizren-Ohër-Vlorë¹. Sipas dokumenteve të zbuluara më vonë, sidomos të atyre të provinencës së arkivave të Raguzës dhe të Stambollit, u dëshmuua se Arbanoni politik Perëndimor shtrihej deri te Prizreni.

Mirëpo, pjesa tjetër e Arbanonit etnogeografik Verilindor, që përfshinte hapësirën e Prizrenit dhe shtrihej në veri deri te Nishi (Naissus), e në lindje deri te Velesi (Bilazora) dhe përtej Shtipit (Astibos), mbeti nën

¹ L. Thalloczy, Jiriček, Zivei, Urkunden aus Nordalbanien, Archiv für Slawische Philologie 21 (1899) 88; I. Prolegomena, f. III-VI; II, 43 (1931) f. 1-37; G. Stadtmüller, Forschungen zur albanischen Fruleschichte, Zweit ermeirlete, Wiesbaden, 1966.

sundimin bizantin, e pastaj në fund të shek. IX dhe gjatë shek. X deri në vitin 1018, ishte nën sundimin bullgar, kurse më vonë, 1186-1189, push-tohet nga Nemanjidët serbë. Kështu, ky territor mbeti nën sundimin serb deri në fund të shek. XIV, kur Perandoria Osmane i pushtoi territoret e Arbanonit etnogeografik Verilindor, tokat e të cilit gjatë sundimit sllav u pagëzuan sipas toponimit të një vendbanimi me emrin - *Kosovë*, që gjendej në afërsi të Novobërdës, ku kishte burime minerare. Ky toponim filloi të marrë emërtimin gjeografik, menjëherë pas Betejës së Kosovës të vitit 1389, ndonëse deri në këtë kohë nuk njihej fare si Kosovë, por hapësira e Arbanonit etnogeografik Verilindor njihej vetëm me emrin Dardania.

Që para ndarjes së kishës perëndimore nga ajo lindore në vitin 1054, 9 vjet më parë (1043) kishte shpërthyer një kryengritje kundër sundimit bizantin, kur popullata e Arbanonit Qendror mesjetar kishte filluar ta ripërhapte kulturën latino-perëndimore në hapësirën e katërkëndshit Tivar-Prizren-Vlorë-Ohër, ajo nuk ishte më shtetase bizantine². Kjo ngase disa fisnikë shqiptarë kishin arritur të formonin një formacion politik dhe shtetëror, duke u shkëputur nga sundimi bizantin dhe nga kisha greke.

Siç dihet, emri i shqiptarëve me formën Albanoi për herë të parë përmendet në gjeografinë e Ptolemeut në shek. II të erës së re, ndërkaq emri kombëtar me formën Arbanoi del i shkruar në veprën *Historia e viteve 1079-1080* të kronistit grek M. Ataliati³. Në anën tjetër, jashtë Arbanonit politik dhe shtetëror kishte mbetur gjysma e tij si pjesë e Arbanonit të mirëfilltë etnogeografik me ndikim të kulturës dhe religjionit bizantino-grek e që shtrihet nga Prizreni deri te Nishi (Naissus), Bilazora (Veseli) e Shtipi (Astibos), që ende mbeti nën sundimin bizantin dhe, nga fundi i shekullit XII (1189) hyri nën sundimin e nemanjidëve serbë.

Se Arbanoni etnogeografik i mesjetës nuk shtrihet vetëm deri te Prizreni e Ohri, siç kanë pohuar medievistët e huaj, por deri atje ku hasen vendbanimet arbane-albane në burimet e shkruara mesjetare të shekujve XIII-XIV-XV, dëshmojnë burimet sllave dhe raguziane, e mëpastaj ato të administratës osmane, në të cilat përmenden Arbanashi i nahijes së Shtipit, Arbanashka i nahijes së Kumanovës⁴ i shek. XIV, Arbanashi i Prokupjes, Arbanashi i Vrajës, si dhe Arbanashi i Xërxës⁵ nga viti 1330-1348, që del i regjistruar dhe i dëshmuar në krisobulën e Deçanit.

² M. Attaliatae, *Historia*, Bonnae 1853, 9, 9, 18, 17. Me këtë emër shqiptarët përmenden edhe tek Anna Komnena.

³ M. Attaliates, ed. E. Bekker, Bon, 1853, 9.

⁴ Miodrag Purković, *Popis sela u srednjovekovnoj Srbiji*, Godišnjak Skopskog Filozofskog fakulteta, Skopje, 1940, 4-8.

⁵ R. Ivanović, *Decanske vlastelinstvo*. Istorijski casopis, Beograd, 1954, knjiga IV, 173-200. Muhamet Tërnavë, *Shqiptarët në feudin e Deçanit në vitet e tridhjeta të*

Vendbanimet mesjetare arbane nuk na dalin vetëm me etnonimin Arbnesh për të menduar se ajo popullatë ishte nomade-endacake, por edhe me emërtime në bazë të gurrës shqipe që dëshmojnë bindshëm se popullata arbane mesjetare ishte autoktone. Këtë e dëshmojnë toponimet e gurrës shqipe: vendbanimi me emrin Rabana ndërmjet Rashkës dhe Nishit, që përmendet në veprën e gjeografit arab Al-Idrisi⁶ nga viti 1152-1153, deri më sot i paubifikuar, pastaj Muzaq⁷ (Muzaqeve kuqe), që dëshmohet në dokumentet mesjetare serbe në vitin 1318)–vendbanim në anën e Prokupjes, pastaj Burmazi në anën e Yeni Pazar-it⁸, e Burmazi tjetër në anën e Bajina Bashtës⁹, ishin të kohës së shek. XIII-XIV, ashtu si Burmazi i Stolcit¹⁰ te Mostari, që përmendet në vitin 1300, përkatësisht në fund të shekullit XIII. Sipas Jireçekut, Burmazët që jetonin në rrethin e Stolcit të Hercegovinës kishin 4 vendbanime kryesisht me emra të antroponimisë sllave, të cilët kanë prejardhje arbane, sepse fjala Burmaz rrjedh nga emri autokton i gurrës shqipe Burri i Madh.¹¹

Vendbanimet Plaka, Kodra, Batusha, Gurguri të dokumentuara në Defterin¹² e timareve të administratës osmane nga viti 1444-1446, dëshmojnë se 10 vjet para pushtimit definitiv të Kosovës Verilindore nga osmanllinjët, në rrethinën e Nishit kishte vendbanime dhe popullatë të krishterë shqiptare. Vendbanimet: Bardus-i¹³ me formën e latinizuar, si dhe Bardin-i¹⁴, Bardiq-i¹⁵ dhe Barllova¹⁶, *Kastrati*¹⁷ me format e sllavizu-

shek. XIV, sipas Krisobulës së Deçanit, Buletini i Fakultetit Filozofik, Nr. XI, Prishtinë, 1974, 256-270.

Rexhep Ismajli, Disa çështje të onomastikës mesjetare, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979, 51-52.

⁶ Al-Idrisi, Kitabu Nuz'heti al-Mushtak fi ihtirak al-Afak, Mektebetu Eththekafeti Eddiniyyeti, Port Said,- IRCICA Library, Istanbul, 1980, f. 795, 894.

⁷ Pavle Ivić-Milica Grković, Dečanske hrisovulje, Beograd, 1976.

⁸ Hauptman Gerba: Die Kaiserlichen in Albanien 1689, Mittheilungen des KK, Kriegs-Archives, Band. II, Wien, 1888, Übersicht des Kriegsschauplatzes in alt-Serbien und Albanien, 1689, Wien, 1880, Gustav Hubka, Die Österreichische-Ungarische-Offizieromission in Makedonien, 1903-1909, Wien, 1910..

⁹ Ibid.

¹⁰ K. Jirecek, Istorija srba, Beograd, 1952, Knjiga I, 85. dhe Libri II, 34.

¹¹ Bogomil Hrabak, O Hercegovačkim vlaškim katunima prema poslovnjoj knjizi dubrovcanina Dživana Pripčinovica, Glasnik zemaljskog Muzeja u Sarajevu, 1956, 30-31.

¹² Evkaf ve timar defteri Nr. 0117, Belediye Kütüphanesi, Istanbul, dhe Timar defteri Nr. 0176, Olga Zirojević-Ismail Eren, Popis oblasti Kruševca, Toplice i Dubočice za vreme prve vladavine Mehmeda II, 1444-1446, Vranjski Glasnik, Vranje, 1968.

¹³ Basbakanlik Arsivi Istanbul, Defter-i Liva-i Alaca Hisar, Nr. 179, Defter Nr. 576 dhe Nr. 176.

¹⁴ BBAI, Tapu tahrir Defteri, Nr. 179, Nr. 576 dhe Nr. 176.

¹⁵ BBAI, Tapu tahrir Defteri, Nr. 179, Nr. 576 dhe Nr. 176.

ara në arealin e Nishit, Prokupjes dhe Kurshumlisë, janë të dokumentuara në defterët kadastralë të administratës osmane të shek. XV-XVI.

*Edhe në temën e Doclea-s*¹⁸ antike, në burimin e lumit Zenta (Genta), sot Moraça, gjendet një vend arkeologjik i njohur, vendi kryesor i fisit ilir Docleat, të cilin e përmend për herë të parë në shek. II të erës sonë gjeografi dhe astronomi antik Klaudi Ptolemeu, si qytet romak – Doclea (Δοκλεα)¹⁹, ku gjejmë vendbanime mbi bazë të etnonimit arbnesht Albanasi²⁰, që përmendet për herë të parë në krisobulën e mbretit Milutin të vitit 1296 në afërsi të vendbanimit të hershëm Gusha, ku dikur kanë jetuar vëllazëria Mataguzhi²¹. Vetë emri i tij dhe i disa lokaliteteve përreth tij flasin se dikur në mesjetën e hershme aty banonin arbanët e vjetër, ndoshta nga fisi Shpuri sikurse quhej një lagje e këtij vendbanimi. Në këtë vendbanim janë zbuluar monedhat e vjetra venedikase me stemën e Shën Markut dhe me mbishkrimin Dalmatiae et Albaniae.²²

Këtu përmendej një banor me emrin Caterina quondam Radossavi Xogovich de villa Arbania de Genta²³, (Katarina e veja e të ndjerit Radosav Zogoviqit nga fshati Arbneshti i Gentës). Pastaj na del Arbanasi²⁴ i nahijes së Rijekës së Malit të Zi, në Defterin e shek. XV-XVI, i cili

¹⁶ BBAI, Timar Defteri nr. 161, Timar Defteri nr. 55.

¹⁷ Übersich des Kriegsschauplatzes in alt-Serbien und Albanien, 1689, Wien, 1880, Gustav Hubka, Die Österreichisch-Ungarische-Offizieromission in Makedonien, 1903-1909, Wien, 1910..

¹⁸ Istorija Crne Gore I, fq. 151-201. Jiriček Radonić, Istorija srba I, 1952, f. 51-97, Gjurgjo Boshković, Problemi urbanizacije, Dukljeansko-Zetsko-Crno Gorskog primorja, Istorijski zapisi XIV, 1958, f. 21-25.

Fanula Papazoglu, Crna Gora u antičko doba, Enciklopedija Jugoslavije II, f. 416. Risto Kovijanjić, Pomeni crnogorskih plemena u kotorskim spomenicima XIV-XVI vijek, libri II, Titograd, 1974. fq. 41-42.

¹⁹ Veprat e citura, Idem, Risto Kovijanjić, Pomeni Crng. Plemena, f. 41-42.

²⁰ St. Novaković c, Zakonski spomenici srpskih država Srednjeg veka, SANU, Beograd, 1912, f. 580, Risto Kovijanjić, Pomeni ... fq. 120-121.

²¹ Andreja Jovičević, Zeta i Leshkopole, Srpski etnografski zbornik, XXXVIII, SANU, Beograd, 192, 545-6

BBAI, Tapu tahrir Defteri, Nr. 106. Branislav Gjurgjev, Dva deftera Crne Gore iz vremena Skender-bega Crnojevića, Prva Sveska, Sarajevo, 1968. Faksimili f. 27 v. 28-29. Branislav Gjurgjev dhe Lamia Haxhiosmanović, Dva Deftera – Druga sveska, Sarajevo, 1973, f. 53-54.

²² Idem, Sveska II, fq. 54.

²³ Risto Kovijanjić, Pomeni... vep. e cit. 120.

²⁴ Idem, f. 121.

²⁴ BBAI, Tapu tahrir Defteri, Nr. 106. Branislav Gjurgjev, Dva deftera Crne Gore iz vremena Skender-bega Crnojevića, Prva Sveska, Sarajevo, 1968. Faksimili f. 27 v. 28-29. Branislav Gjurgjev dhe Lamia Haxhiosmanović, Dva Deftera – Druga sveska, Sarajevo, 1973, f. 53-54.

kishte 65 kryefamiljarë (shtëpi) me 20 bashtina. Antroponimia e kryefamiljarëve të këtij Arbneshi ishte krejtësisht e sllavizuar, përveç dy emrave me trajta të shqipes- Lesh-ko Nikolla dhe Dimiter Petro dhe bashtina e Gjonit në zotërim të Radosavit e bashtina e Leshit.²⁵ Ndërsa në Arbanasin²⁶-Arbneshin tjetër në nahijen e Krajës²⁷-Ostrosit kishte 37 shtëpi me 37 kryefamiljarë e një beqar të krishterë dhe 2 kryefamiljarë të besimit islam.

Emrat e kryefamiljarëve të këtij vendbanimi, për dallim nga Arbneshi i nahijes së Rijekës, ishin kryesisht të sferës së onomastikonit tradicional shqiptar, me përjashtim të 3 kryefamiljarëve që mbanin emrat sllavë me format shqipe (me formantin -a, si Vuk + a = Vuka), ndërsa mbiemrat shqiptarë, si p.sh.: Vuka Doda, Vuka Kolja dhe Vuka Marki.²⁸

Gjurmë toponimike me etnonimin *arbnesht* gjejmë edhe në juglindje të Cetines së sotme, ku na del toponimi Arbanashki Do²⁹ = Lugu i Arbneshit, si dhe mikrotoponimi nga apelativi i shqipes Arbanashka Medja³⁰ = Kufiri-Sinori i Arbneshit.

Po ashtu në arealin e Ostrosit të Krajës kemi një mikrotoponim me emrin Vavi i Arbneshit.³¹

Në bregdetin dalmatin të Kroacisë në mesjetë hasen edhe dy vendbanime me etnonimin *arbnesht*, si Arbania³² afër Trogirit nga shek. XV dhe Arbneshi i Kashtelit afër Shibenikut, e në një defter osman të shek. XV përmenden edhe vendbanime të tjera me bazën e shqipes në rrethinën e Raguzës.³³

Për sa i përket Arbneshit të Zarës në të cilin vendosen arbneshtët e shpërngulur nga Kraja dhe Shestani në vitet 1726, 1732 dhe 1733, disa studiues si Idriz Ajeti, Pavle Mijoviq e të tjerë, mendojnë se atë e formuan Arbneshtët e Krajës në vitet e përmendura.

²⁵ Idem, Sveska II, fq. 54.

²⁶ Kadastro ve Tapu müdürlüğünün arsivi, Ankara, Defter-i Liva-i Iskenderiye nr. 59, f. 98.

²⁷ TKA, Defteri nr. 59.

²⁸ TKA, Defteri nr. 59.

²⁹ Idriz Ajeti, Studime leksikore shqiptare-sllave, Gjurmime Albanologjike, 2, 1968, Prishtinë, 1969, 39.

³⁰ Idem, fq. 39, Ismail Doda, Rreth identifikimit të disa toponimeve të Krajës, Onomastika e Kosovës, Simpoziumi i mbajtur më 25-27 shkurt 1977, Prishtinë, 1979, fq. 173-178.

³¹ Ismail Doda, vep. e cit. fq. 182.

³² Hauptman Gerba: Die Kaiserlichen in Albanien 1689, Mittheilungen des KK, Kriegs-Archives, Band. II, Wien, 1888, Übersicht des Kriegsschauplatzes in alt-Serbien und Albanien, 1689, Wien, 1880, Gustav Hubka, Die Österreichisch-Ungarische-Offizieromission in Makedonien, 1903-1909, Wien, 1910.

³³ Tapu ve Kadastro Defteri nr. 7.

Njoftimet e para për historinë e shqiptarëve dhe të vendbanimeve të tyre në mesjetë i gjejmë në burimet bizantine duke filluar nga gjysma e parë e shek. XI, në të cilat për herë të parë ata përmenden me një emër të përgjithshëm Arbanoi, që njihet që nga shek. II i erës së re në veprën e gjeografit grek Ptolemeu³⁴, por me formën tjetër Albanoi, si emër i një fisi ilir, kurse emri i qytetit kryesor Albanopolis dhe Albana³⁵ në Shqipërinë Qendrore, dhe Albana³⁶ në Ballkan. Sipas disa studiuesve dhe Thoma Kaçorrit³⁷ del se Albanopolisi ishte në afërsi të Durrësit tek malet Kandave (Malet e Polisit) në lindje, brenda trevës së banuar më herët nga fisi Parthinët.

Si gjurmë të këtyre toponimeve sot kemi Arbana, vendbanim në rrethin e Tiranës, pastaj kroi Alban, në afërsi të fshatit Zgërdhesh në rrethinën e Krujës, etj. Viset e Arbanonit mesjetar në burimet latino-perëndimore përmenden me formën Arbanum³⁸, Albanum, ndërsa në ato sllave Raban³⁹ dhe Rabania.

Viset mesjetare shqiptare sipas burimeve më të reja historike të trajtuara nga studiuesit tanë S. Pulaha⁴⁰ e M. Tërnavë⁴¹, si dhe studiuesi boshnjak A. Hanxhiq⁴², shtriheshin edhe në Kosovën e sotme dhe në Maqedoninë Perëndimore.

Për shtrirjen e etnonimit Arban-Arbnesh kanë shkruar edhe disa autorë shqiptarë si Dh. Shuteriqi⁴³, Koço Bozhuri⁴⁴, K. Luka⁴⁵, K. Frashëri⁴⁶, E. Sedaj⁴⁷, D. Luka⁴⁸, R. Doçi⁴⁹ e të tjerë.

³⁴ Ptolemaei Geographica, lib. III, in; Ilir dhe Iliria te autorët antik; I, Tiranë, 1965, 268.

³⁵ Idem, 266.

³⁶ Sh. Sejdiu, « bijelo » u onomastici Dardanije, in Zvornik VI, jugoslovenske onomastičke konferencije, Beograd, 1987, f. 564.

³⁷ Po aty, vep. e cit.

³⁸ Anna Commnena, Alexiade Bonnae, 1839, vëll. I, 221,

³⁹ Anna Commnena, vep. e cit. I, III-IV.

⁴⁰ Selami Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, Shtypshkronja "8 Nëntori", Tiranë, 1984.

⁴¹ Dr. Muhamet Tërnavë, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995.

⁴² Adem Handžic, Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka. Simpoziumi për Skënderbeun, Prishtinë, 1969, 201-209.

⁴³ Dh. Shuteriqi, Mbi disa çështje të Arbërit dhe mbi emrin Shqipëri, Buletin, seria e shkencave shoqërore, Tiranë, 1956.

⁴⁴ Koço Bozhuri, Vëzhgime rreth shtrirjes së emërimit Arbanon në kohën Bizantine, Studime historike, Tiranë, 1972, 135-140..

⁴⁵ K. Luka, Toponomia shqiptare në këngët Roland-it, lidhur me disa ngjarje të viteve 1081-1082, Studime historike 2, 1967, 127-144; Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1969, 155-161. I njëjti autor: Mbi emrin Albei nje-Albania dhe shtrirja e Arbenit në shek. XI, fillimi i XII, në Konferencën e Dytë të Studimeve Albanologjike Vëll. 2, Tiranë, 1969, fq. 155-161.

Për dallim nga këta autorë, të cilët Arbanonin mesjetar e përkufizojnë sipas shkrimeve të medievistëve të huaj, S. Pulaha⁵⁰, M. Tërnavë⁵¹ dhe K. Biçoku⁵², në bazë të burimeve të reja, viset etnike mesjetare shqiptare i zgjerojnë duke përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë Perëndimore.

Etnonimi *arbnesh*, qoftë në funksion të patronimit apo të toponimit, i cili është përdorur gjatë shekujve të mesjetës si emër etnik, qysh herët është bërë objekt i studiuesve të huaj dhe shqiptarë. Mendimet e disa historianëve dhe linguistëve për etimologjinë e këtij emri, për kohën e përhapjes së tij dhe për shtrirjen gjeografike të viseve të banuara nga shqiptarët gjatë mesjetës, janë analizuar në mënyrë kritike nga autorët e zënë ngjohje, por në aspektin filologjik dhe linguistik në mënyrë kritike nga E. Çabej⁵³, Sh. Demiraj⁵⁴, Sh. Sejdiu⁵⁵, I. Ajeti⁵⁶, R. Ismajli⁵⁷, E. Sedaj⁵⁸, S. Gashi⁵⁹, R. Doçi⁶⁰, M. Halimi⁶¹ e të tjerë.

Sa i përket çështjes së paraqitjes së etnonimit *arban* për herë të parë dhe cila është forma e tij e mëhershme *Arban* apo *Alban*, studiuesi Shaban Demiraj thotë se lidhur me këtë etnonim na paraqiten disa vështirësi

⁴⁶ Kristo Frashëri, Trojet e shqiptarëve në shek. XV, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1969, II, 109-119.

⁴⁷ E. Sedaj, Etnonimi Arbëresh-Shqiptar (kontribut për autoktoninë e shqiptarëve), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1996,

⁴⁸ D. Luka, Vështrim gjuhësor mbi onomastikën e regjistrave kadastralë osmanë të shek. XV, Studime Filologjike, nr. 4, Tiranë, 1983, fq. 154-155.

⁴⁹ R. Doçi, Antroponomia e shqiptarëve të Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1990. fq. 34-45.

⁵⁰ Popullsia shqiptare e Kosovës, vep. e cit.

⁵¹ Popullsia e Kosovës, vep. e cit.

⁵² Kasem Biçoku, Viset etnike shqiptare në mesjetë dhe përhapja e emrit kombëtar Arbër (Arbëri-Albani), Stud. hist. Nr. 1-4, Tiranë, 1992, fq. 13-21.

⁵³ E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, Bleu II, A-B, Tiranë, 1976, 61-69.

⁵⁴ Sh. Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë, 1988, 213-228.

⁵⁵ Shefki Sejdiu, Gjurmë lashtësie në onomastikën e trevës së Llapit, Sesioni shkencor, Trashëgimia etnokulturore të trevës së Llapit, Prishtinë, 1996, I njejtë autor në librin me titull: "Sprova Etimologjike", Prishtinë, 2002, 59-66.

⁵⁶ Idriz Ajeti, Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994.

⁵⁷ Rexhep Ismajli, Disa çështje të onomastikës mesjetare, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979, 51-52.

⁵⁸ Engjëll Sedaj, Etnonimi Arbnesh-Shqiptar, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996. fq. 72-78.

⁵⁹ S. Gashi, Prania e shqiptarëve në Kosovë gjatë shek. XIII-XIV, në dritën e burimeve kishtarë serbe, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979, 60-102.

⁶⁰ R. Doçi, Antroponomia e shqiptarëve të Kosovës ... po aty, vep. e cit.

⁶¹ M. Halimi, Toponimet si dëshmi e autoktonisë së popullsisë shqiptare në Maqedoni, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, fq. 88-90.

që ende nuk janë kapërcyer plotësisht.⁶² Ai, duke analizuar këtë temë, konkludon se, nëse mbështetemi në trajtën e përdorur nga vetë shqiptarët, atëherë si trajtë parësore del ajo me (r) ; *Arb-* dhe jo ajo me (l) *Alb*, që del në dokumentet latine krahas asaj me (r). Edhe trajtat sllave Arban-as dhe Raban dëshmojnë se sllavët e Ballkanit në kontakt me stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm këtë temë e kanë dëgjuar me (r). Edhe tek fqinjët tanë jugorë, grekët, në dokumentet historike dëshmohet trajta me (r): Arvan-on. Por, nëse kjo temë lidhet historikisht me Alban-oi dhe Alban-o-polis të Ptolemeut, atëherë tema me (l) del e dokumentuar më herët. Dhe, duke qenë se këto emërtime të Ptolemeut i referohen një treve që përkon me zonën prej nga janë përhapur toponimi *Arban* dhe etnonimi *Arbnesh*, atëherë mbetet për t'u shqyrtuar se cila ka qenë trajta burimore e këtyre emërtimeve, ajo me (r) apo ajo me (l).⁶³

Përhapja e etnonimit arbnesh është e lidhur ngushtë me hapësirën etnogeografike të banuar nga shqiptarët gjatë mesjetës. E. Çabej, në studimet e tij qysh herët ka bërë të ditur se vendbanimi i sotëm i shqiptarëve nuk është një trevë ekspansioni, por trevë e tkurrjes dhe e një ngushtimi të pandërprerë gjatë historisë së popullit shqiptar.⁶⁴

Në një studim tjetër Çabej edhe një herë ka vënë në dukje se në tokat e shqiptarëve kanë bërë pjesë edhe viset bregdetare që nga Raguzja e deri në Artë.⁶⁵

Në krahinat lindore të tokave shqiptare ishin përfshirë qytete të tilla si Nishi, Shkupi, Ohri⁶⁶, Prizreni, etj.

Viset-vendbanimet përgjatë rrugës së njohur mesjetare Nish – Shkup – Manastir – Kostur – Janinë – Artë - Prevezë, gjatë mesjetës kanë qenë të banuara kryesisht me popullsi shqiptare. Edhe burimet historike, si dokumentet e kohës, hartat dhe kronikat e vjetra gjatë mesjetës tregojnë se këto hapësira gjeografike ishin të banuara me popullatë shqiptare. Në kohë të fundit janë zbuluar të dhëna të kulturës materiale të shqiptarëve të hershëm në një hapësirë gjeografike që nga bregu veriperëndimor i liqenit të Shkodrës, në veri, në Vir Pazar të Malit të Zi të sotëm e deri në

⁶² Sh. Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, vep. e cit. fq. 182.

⁶³ Sh. Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, vep. e cit. fq. 182.

⁶⁴ E. Çabej, Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e shkencave shoqërore, Tiranë, 1958, Nr. 2, 54-67.

⁶⁵ E. Çabej, Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin e Ballkanit në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve BUSHT, Tiranë, 1962, 219-226.

⁶⁶ E. Çabej, Problemi i autoktonisë, vep. e cit. fq. 55.

Afion të Korfuzit, në jug, kurse në lindje pranë liqenit të Ohrit, në fshatrat Orovnik dhe Ladorisht⁶⁷ (Radolisht).

Gjurmët e etnonimit mesjetar *arban-arbnesh* i hasim edhe në toponomastikën historike të Arbanonit etnik mesjetar që përmenden në shek. XIV - vendbanimi Arbanashka⁶⁸ i Kumanovës, Arbanash i Shtipit dhe Arbanash i Radomirit-Qystendilit, si dhe fshati shqiptar Muzaq⁶⁹ i Prokupjes i dokumentuar me emrin Muzaceve kuce në krisobulat serbe nga viti 1318.

Vendbanime shqiptare me etnonimin *arbnesh* dhe me emërtimet e gurrës shqipe i hasim edhe më dendur në rrethinat e Nishit, Krushevcit, Leskovcit, Prokupjes, Kurshumlisë dhe të Vrajës gjatë shek. XV dhe atij XVI në regjistrat kadastralë osmanë, siç ishin: Bardus⁷⁰ me trajtën e latinizuar në rrethinën e Kurshumlisë, Bardis⁷¹ me formën e greqizuar në rrethinën e Prokupjes, Bardiq⁷² me formën e sllavizuar në rrethinën e Petrushës-Knjazhevc, Tanus⁷³ me formën e latinizuar apo Tanush me formën shqipe në rrethinën e Prokupjes, Lulis-a e Epërme⁷⁴ nga apelativi i gjuhës shqipe Lule, me formën e greqizuar dhe formantin - a të sllavishes, si dhe Lulis-a e Poshtme⁷⁵ po ashtu me formën e greqizuar në rrethinën e Leskovcit, tani të zhdukura, por patronimi Lulo⁷⁶ është ruajtur deri në vitin 1878 në këtë krahinë, kur shqiptarët u dëbuan me dhunë sipas një dokumenti të adminsitratës shtetërore serbe të asaj kohe, sipas të cilit, mbreti serb Milan Obrenović krenohej duke thënë: « Arritëm që me shpatë e zjarr ta shndërojmë rajonin e Toplicës prej një toke thjesht të banuar me popullsi shqiptare, në një tokë të pastër serbe ».⁷⁷



⁶⁷ Skender Anamali, *Nga Ilirët tek Arbërit, Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Tiranë, 1982, 109.

⁶⁸ Miodrag Marković, *Popis sela u srednjovekovnoj Srbiji, Godišnjak Skopskog filozofskog fakulteta*, Skopje, 1940, 4-8.

⁶⁹ Pavle Ivić Milica Grković, *Dečanske hrisovulje*, Beograd, 1976.

⁷⁰ BBAI, *Tapu tahri defteri*, Istanbul, *Defteri-i Liva-i Alaca Hisar*, N° 179 dhe Nr. 576.

⁷¹ Ibid.

⁷² Ibid.

⁷³ Olga Zirojevic, Ismail Eren, *Popis oblasti Krusevca, Toplice i Dubočice za vreme prve vladavine Mehmeda II, 1444-1446*, Vranjski Glasnik, Vranje, 1968.

⁷⁴ BBAI Istanbul, *Maliye Defteri* Nr. 7. f. 4-8.

⁷⁵ BBAI Istanbul, *Maliye Defteri* Nr. 7. f. 4-8.

⁷⁶ Dr. Sabit Uka, *Gjurmët mbi shqiptarët e Sanxhakut të Nishit deri më 1912*, Prishtinë, 1995, fq. 118-150.

⁷⁷ M. Marković, *Toplicka Spomenica, Udruženje topličana u Beogradu*, Bgd, 1934, fq. 10-32.

Në rrethinat e Toplicës dhe të Dubočicës na dalin me origjinë shqiptare edhe këto toponime të shek. XV-XVI: Dashinc e Epërme⁷⁸ dhe Dashinc e Poshtme⁷⁹, Kodra⁸⁰, Plaka⁸¹, Maliçka⁸², Maletin⁸³, Malushisht⁸⁴, Malç⁸⁵, Maleva⁸⁶, Butina⁸⁷, Botusha⁸⁸, Biba⁸⁹, Biboshinc⁹⁰, Guri Baba⁹¹ (Guri Plakës), Gurguri⁹² i formës shqipe dhe në hartat topografike del me formën sllave Grgure⁹³, si dhe vendbanime me etnonimin *Arbnesh-Arbanas* me nga dy emërtime në hapësirën e Sanxhakut të Krushevcit, siç ishin: Krushevic⁹⁴ emri tjetër Arbanash, Sushic⁹⁵ emri tjetër Arbanash, Hobotinc⁹⁶ emri tjetër Arbanash. Edhe disa dhjetëra vendbanime të tjera me substratin e shqipes, që përmenden në këta regjistra kadastralë osmanë dëshmojnë në mënyrë të bindshme se këto vendbanime ishin të banuara me popullsi shqiptare qysh në mesjetën e hershme, para depërtimit të bullgarëve në këto vise, pra para shek. X, e të cilat u sunduan nga bullgarët më se 100 vjet para pushtimit të tyre nga administrata serbe e Nemanjidëve.

⁷⁸ Olga Zirojevic, Ismail Eren, Popis oblasti Krusevca, Toplice i Dubočice za vreme prve vladavine Mehmeda II, 1444-1446, Vranjski Glasnik, Vranje, 1968.

⁷⁹ Po aty, vep. e cit.

⁸⁰ Evkaf ve timar Defteri Nr. 0117, Belediye Kütüphanesi, Istanbul,

⁸¹ Evkaf ve timar Defteri Nr. 0117, vep. e cit.

⁸² Evkaf ve timar Defteri Nr. 0117, Belediye Kütüphanesi, Istanbul, Olga Zirojevic, Popis... vep. e cit. fq. 404.

⁸³ BBAI, Tapu tahrir defteri, Istanbul, Defteri-i Liva-i Alaca Hisar, Nr. 179 dhe Nr. 576.

⁸⁴ BBAI Tapu tahrir defteri-Defter-i Liva-i, Niš, nr. 27 nga viti 1487. fq. 5-10.

⁸⁵ BBAI Tapu tahrir defteri-Defter-i Liva-i, Niš, nr. 27 nga viti 1487. fq. 5-10.

⁸⁶ BBAI, Istanbul, Tapu tahrir defteri – Defter-i Liva-i, Alaca Hisar Nr. 179 dhe Nr. 576.

⁸⁷ Evkaf ve timar Defteri Nr. 0117, Belediye Kütüphanesi, Istanbul, Olga Zirojevic, Popis... vep. e cit. fq. 404.

⁸⁸ Evkaf ve timar Defteri Nr. 0117, Belediye Kütüphanesi, Istanbul, Olga Zirojevic, Popis... vep. e cit. fq. 404.

⁸⁹ BBAI Tapu tahrir Nr. 179, TD nr. 576.

⁹⁰ BBAI Tapu tahrir Nr. 179, TD nr. 576.

⁹¹ BBAI, Tapu tahrir defteri Nr. 179, dhe Nr. 576.

⁹² Evkaf ve timar Defteri Nr. 0117, vep. e cit.

⁹³ Hauptman Gerba: Die Kaiserlichen in Albanien 1689, Mitheilungen des KK, Kriegs-Archives, Band. II, Wien, 1888, Übersicht des Kriegsschauplatzes in alt-Serbien und Albanien, 1689, Wien, 1880, Gustav Hubka, Die Österreichisch-Ungarische-Offizieromission in Makedonien, 1903-1909, Wien, 1910.

⁹⁴ BBAI Tapu tahrir Nr. 179,

⁹⁵ BBAI Tapu tahrir Nr. 179,

⁹⁶ BBAI Tapu tahrir Nr. 179,

Përveç këtyre vendbanimeve të hapësirës së sipërpërmendur mbi bazë të shqipes, sipas Defterit kadastral të fundshekullit XV⁹⁷ për herë të parë përmenden vendbanime edhe në territorin e Kosovës Verilindore, përkatësisht në rrethinën e Novobërdës, e cila përfshinte Rudarin, Medvegjën dhe pjesë të skajeve të territorit të Leskovcit të sotëm, siç ishin: Petrili i Arbneshit (të Medvegjës), Bernicë e Arbneshit dhe Arbneshi i Zebincës, Leshofci, Nerlisa, Binest Kuq-a (Vinesit Kuq-a), Molofça (Malofça), Petriza, Gurishefc-i, Malkuqa (Mali /i/ Kuq), Tanusha (që sot gjendet 3-4 km në lindje të Hanit të Elezit), Gjonça (Gjoni) dhe Hrospinzi i Arbneshit, të cilat përmenden edhe në librin e tregtarit raguzian Mihail Lukareviq⁹⁸ nga viti 1432-1438 në nahijen e Ostrovicës së kazasë së Novobërdës, pra 15 vjet para pushtimit të Kosovës nga osmanllinjtë. Gjonça⁹⁹ e regjistruar në librin dhe defterin e përmendur që ende nuk është ubifikuar, ndërsa Hrospinzi i Arbneshit si toponim dygjymtyrësh, sot ekziston vetëm me një emër – Hrospinzi në afërsi të Medvegjës, etj.

Vendbanime mesjetare me etnonimin *Arbnesh* ka pasur edhe në hapësirat e Pazarit të Ri dhe të Bosnjës Lindore, si: toponimi Arbanas Imshtariq¹⁰⁰ dhe Mezra Arbanas¹⁰¹ në nahijen e Boraçit, Arbanas afër Rudos¹⁰², që gjendeshin ndërmjet Rudos dhe Vishegradit në Bosnjë, Arbanashka të Trebinjes¹⁰³, pastaj Berishina Luka¹⁰⁴ -Lugu i Berishës te Prijepolja, Malevçe-Malevci¹⁰⁵, Tarkus-Tarkos¹⁰⁶-me formën e latinizuar me –us, apo me formën e greqizuar me –os, (nga apelativi i shqipes thark), Malosh¹⁰⁷ (Malesh)-oronim në afërsi të Pazarit të Ri.

⁹⁷ Iljaz Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së Kazasë së Novobërdës sipas Defterit të fundshekullit XV, Vjetari XXVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë, 2002, fq. 43-174.

⁹⁸ Mihajl Dinić, Iz Dubrovačkog arhiva I, SAN, Zbornik za istoriju, jezik i knjizevnost srpskog naroda, III odeljenje, knjiga XVII, Beograd, 1957, 29-84.

⁹⁹ Iljaz Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë. vep. e cit. fq. 143.

¹⁰⁰ Belediye Kütüphanesi, Istanbul. Vakuf ve Timar defteri Bosna-Herceg. Defteri. 872-881 H. 1467-1477.

¹⁰¹ Tapu ve Kadastro Arshivi, Ankara, Defteri Nr. 5.

¹⁰² Tapu ve Kadastro Arshivi, Ankara, Defteri nr. 5. Imenik mesta, opština i srezova u Jugoslaviji, Beograd, 1960, fq. 66.

¹⁰³ Imenik mesta, opština i srezova u Jugoslaviji, Beograd, 1960, fq. 66.

¹⁰⁴ BBAI Tapu tahrir Defteri Nr. 995,

¹⁰⁵ BBAI Maliye Defteri nr. 544,, Belediye Kütüphanesi, Bosna Hersek. Defteri Nr. 076, f. 140, Dr. Hazim Sabanovic, Krajište Isa-Bega Ishakovica, Zbirni katastarski popis iz 1455, god. Sarajevo, 1964, fq. 47.

¹⁰⁶ BBAI, Maliye Defteri nr. 544, Bosna Hersek. defteri, nr. 76. fq. 5. Dr. H. Sabanovic, vep. e cit. fq. 41.

¹⁰⁷ Dr. Danilo Barjaktarević, Toponimija sela Petnjika, Buletin i Muzeut të Kosovës, XV-XVI, Prishtinë, 198, fq. 253-254.

Sipas Milivoje Pavloviqit¹⁰⁸, onomastit të njohur serb, oronimi i tipit mal, i bazës ilire, apo mal, i bazës arbane, mund të krahasohet me oronimin e formës latine monts dhe me atë të formës së sllavishtes gora. Po edhe sipas linguistit Danilo Barjaktareviq¹⁰⁹, apelativin me bazën mol, mal, indoeuropeistët e vendosin në Ilirikum. Në rrethinën Pazarit të Rikemi edhe këto toponime me bazën shqipe: G. Lulaç¹¹⁰ dhe D. Lulaç me formën e sllavizuar nga apelativi i fitonimit të shqipes lule, Plakova¹¹¹ (në Salname¹¹² na del forma Plaka), Barlovi¹¹³, Sharonja¹¹⁴, Detani¹¹⁵ (nga apelativi i shqipes deti), Gurikuq¹¹⁶ në afërsi të Beranës. Toponimi Arbanashovik¹¹⁷ i nahijes së Kllopotnikut, që gjendej diku ndërmjet Ribariqit dhe Tutinit, meqë është i regjistruar me forma të sllavizuara, dëshmon se në mesjetën e hershme parasllave ekzistonin këto vendbanime.

Shfaqja e emrit *arbër* dhe e toponimit *Arbëri* nëpër kronika dhe nëpër dokumente arkivore dhe historike me një shtrirje shumë të gjerë gjeografike, si në Arbanonin Qendror, po ashtu edhe në atë Verilindor dhe Jugor, dëshmon se banorët autoktonë e përdornin këtë etnonim popullor. Studiuesi i mirënjohur Shaban Demiraj, në bazë të analizave gjuhësore ka nxjerrë përfundimin se etnonimi arbnesht mesjetar i popullit tonë përdorej si nocion i identitetit kombëtar jo vetëm nga shqiptarët, por edhe nga popujt në fqinjësi- grekët, bullgarët, serbët, kroatët, etj. dhe ky emër

¹⁰⁸ Milivoje Pavlović, Toponimija okoline Vranja, Vranjski Glasnik, 1968, Vranje, f. 319. Za oronim ilirskog tipa *mal., il. arb. mal' (cf. moj navedeni referat i clanak) ja sam dovoljno jasno ukazao na susret sa oronimom lat. tipa mont- slav. gora i semanticki oamostaljenim oronimskim terminom plan-ina (cf. l. planus, plana). Ovdje konstatovani primeri upotpunjuju merzu tipa mal (Males-Malesh, Malca-Malç, Maljen i dr.), a prema tipu Mucanj -Muçanj (Monti -), imamo nov konstatovan primer Motin (s. Zlatokop), s napomenom da je on > o izvršeno pre slavizacije.

¹⁰⁹ Dr. Danilo Barjaktarevic, Toponimija sela Petnjika, Buletin i Muzeut të Kosovës, XV-XVI, Prishtinë, 198, fq. 253-254.

¹¹⁰ Belediye Kütüphanesi, Istanbul. Vakif ve Timar defteri Bosna-Hersek. Defteri. nr. 076, fq. 5. Dr. Hazim Sabanovic, Krajiste.... vep. e cit. fq. 12 45 dhe 49.

¹¹¹ Belediye Kütüphanesi, Istanbul. Vakif ve Timar defteri nr. 076, fq. 3.

¹¹² Salnamja, vep. e cit. fq. 703.

¹¹³ Salname-i Vilajet-i Kosova, 1318 H – 1900, Üsküp, fq. 700.

¹¹⁴ BBAI, Tapu tahrir Defteri nr. 211, fq. 153, Belediye Kütüphanesi, Bosna Hersek defteri shek. XV, fq. 140, Salnamja, vep. e cit. fq. 700-703.

¹¹⁵ BBAI, Defter-i Vilayet-i Vlk. nr. 2, Oblast Brankovica Opsirni katastarski popis iz 1455 god. Orijentalni Institut, Sarajevo, 1972, fq. 17., Salnamja, vep. e cit. fq. 700-703.

¹¹⁶ Tapu ve Kadastro Arshivi, Ankara, Defteri nr. 59. Salnamja e Vilajetit të Kosovës, vep. e cit. fq. 860.

¹¹⁷ BBAI, Tapu tahrir Defteri nr.9, Timar Defter-i nr. 16, dhe Defter-i nr. 22,

ishte i njohur dhe përdorej nga këta popuj që më herët, por jo më vonë se në shek. X.¹¹⁸

Edhe në anën e Arbanonit etnik Lindor ekzistonin vendbanime me etnonimin *Arbër*, siç ishin fshati Arbinova në verilindje të Ohrit, Maja e Malit të Arbërit dhe vendbanimi Arbin, pastaj në rrethinat e Tetovës, Shkupit, Kumanovës dhe Shtipit.¹¹⁹

Gjurmët e emrit popullor arbër ruhen edhe në Arbanonin etnik Jugor (Epir), meqë në rajonin e Filatit ndodhet vendbanimi me emrin Arbenic, të cilit nga administrata greke i është ndërruar emri në *Argyrotopas*¹²⁰ dhe në jug të Janinës vendbanimi Arborushi, që sot njihet me emrin grek *Mistra*.¹²¹ Sipas një regjistri kadastral osman të shek. XV, më 1395 vendbanimet në arealin e Peloponezitet Verior e Qendror (Morea) ishin regjistruar si fshatra me popullsi arbane.¹²² Gjatë mesjetës popullsia shqiptare banonte edhe në vise të tjera të Ballkanit Jugor.

Në veprën e autorit bizantin më të hershëm K. Porfyrogent gjatë shek. X del qartë se emri mesjetar i popullit shqiptar ishte i njohur që në kohën e tij, dëshmi kjo e konstatuar për herë të parë nga medievisti Pllum Xhufi.¹²³ Emri *Arbanon* dhe *Albani* ishte bërë i njohur qysh herët në vendet e Evropës Perëndimore dhe zuri vend edhe në veprat letrare që në shek. XI kur emri Albani del në disa motërzime të Këngëve të Rolandit¹²⁴ dhe, më 1188 është përmendur disa herë nga francezi Aimon de Varennes në romanin « Florimon ».¹²⁵

Sipas albanologut tonë më të njohur Eqrem Çabej, emri *arbër* është më i vjetër se ai *alban*, por të huajt e bënë ndërrimin e tingujve nga r në l. Ndërkaq trajta sllave arbanas rrjedh nga një zgjerim i hershëm i zhdukur i

¹¹⁸ Sh. Demiraj, vep. e cit., 219-226.

¹¹⁹ Q. Murati, Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni, Shtëpia botuese, "Fan Noli", Tiranë, 1993, fq. 8-9. M. Pirraku, Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, Prishtinë, 1989, 72. Regno d'Albania. Istituto Geografico Militare, Firenze, 1939. Harta fizike-politike e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1973.

¹²⁰ A. K. Papadhopulos, "Aperios" hora. O ai kaumemkoos Elenizmos kai o Allvanikos Ethnikismos, Athena, 1992, f. 133.

¹²¹ D. Kaljusios. To monasteri tes Kapinas. Epirotike Estia". Nr. 40, 1991 (Iantina), f. 32.

¹²² R. Stojkov-Thoma Kaçorri, Një regjistër Osmano-Turk i shek. XV për shqiptarët e Peloponezitet, Studime historike, Tiranë 1966, Nr. 3, 149-163.

¹²³ P. Xhufi, Arbërit dhe Arbëria në burimet historike të shek. V-XI, Shkenca dhe jeta, Tiranë, 1988, Nr. 2, 54-55.

¹²⁴ K. Luka, Emri Albeinje – Albani dhe shtrirja e Arbërit në shek. XI, në fillim të shek. XII, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, II, Tiranë, 1969, 155-160.

¹²⁵ R. Ushaku, Roman I shek. XII me syzhe shqiptar-ballkanik, "Rilindja", Prishtinë, 3.XI.1984, 12.

shqipes me as, formant për emra banorësh, si vendas, beratas¹²⁶, njësoj sikurse edhe prishtinas, prizrenas, tiranas (-I.R.) etj. dhe kronologjikisht i takonte një periudhe më të vjetër, kohës së kontakteve të hershme arbanosllave të mesjetës.¹²⁷

Dijetari kroat Petar Skok¹²⁸ thotë se sllavët dhe arumunët e kanë ruajtur sufiksën -as, i cili i përgjigjet sllavishtes jani, kështu që Arbanas do të thotë banor i qytetit Rabna, Rabnjanin.

Grekët, arumunët dhe sllavët emrin etnik të shqiptarëve e morën nga baza e hershme -arb-, -arban-, e jo nga -alb-, -alban-, që është trajtë latine, e cila filloi të përdoret më dendur vetëm nga koha e anzhujve, si Albanenses e Albania (shek. XIII), ndërsa në latinishten mesjetare kemi format Arbanenses (1166) dhe Arbanum (1204), përkatësisht para trajtës së formuar me bazën -alb-. Në dokumentet greke këtë etnonim e hasim edhe në trajtat: arvanon, alvanon, arvanitis. Pikërisht osmanët-turqit me anë të metatezës e shndërrojnë trajtën greke në Arnavit e nën ndikimin e harmonisë së zanoreve të gjuhës turke në Arnavut-Arnaut. Sllavët e përdorën edhe variantin tjetër me anë të metatezës-Rabani, Rabeni, Rabana. Mirëpo, marrë në përgjithësi, në dokumentet e tyre mesjetare për njerëzit dominoi trajta arbanas dhe për vendin Arbania. Kjo trajtë e trashëguar nga trajta më e hershme greke dhe sllave u përdor edhe në defterët kadastralë të administratës osmane gjatë shek. XV. Trajta në fjalë përmendet në Defterin për Sanxhakun e Arvanitit Mesjetar, që e botoi historiani i njohur turk Prof. H. Inalcik¹²⁹, në Defterin Vilajet-i VlK¹³⁰ dhe e ribotoi një grup paleografësh osmanë nga Sarajeva; pastaj në Defterin e fundshekullit XV që e botoi Iljaz Rexha¹³¹, i cili këtë formë e kishte hasur të shënuar në burimet e kishës dhe administratës sllave për vendbanimet shqiptare mesjetare, që më herët kishin qenë nën sundimin e shtetit bullgar dhe atij serb mesjetar.

Këto vendbanime u regjistruan me emërtimin arbneshe e jo me atë arnaut, me qëllim që të mos krijohen probleme në dokumentet financiare dhe fiskale rreth obligimeve e detyrimeve të shtetasve osmanë, që ishin nën sundimin osman. Mirëpo, nga fundi i shek. XV dhe fillimi i atij XVI,

¹²⁶ E. Çabej, *Studica Albanica I*, Tiranë, 1972, 38.

¹²⁷ Qemal Murati, vep. e cit. fq. 34-35.

¹²⁸ P. Skok, *Etimološki rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*, JAZU, Zagreb, 1971, 54.

¹²⁹ Halil Inalcik, *Hicri 835 Tarihi, Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanid*, Ankara, 1954.

¹³⁰ H. Begic, H. Handžić, E. Kovačević, *Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. god.*, Sarajevo, 1972,

¹³¹ I. Rexha, *Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së Kazasë së Nova Bërdës, sipas Defterit të fundshekullit XV, Vjetari XXVII-XXVIII/2002 i Arkivit Kombëra të Kosovës, Prishtinë, 2002.*

administrata osmane filloi ta zëvendësojë formën e etnonimit të patronimizuar arban-arbanas, siç kishte vepruar më herët me formën greke të etnonimit të patronimizuar arvanit, duke formuar trajtën që i përshtatej natyrës së gjuhës turke-osmane arnavut, mirëpo toponimet me bazën arb-nesh nuk i ndryshoi, gjë që është shumë e rëndësishme nga aspekti historik meqë këto vendbanime dëshmojnë shtrirjen, hapësirën dhe vazhdimësinë etnogeografike të përhershme të popullsisë shqiptare në këto vise në mesjetë.

Do theksuar se administrata osmane që në shek. XII-XIII, nën ndikimin e administratës greke me të cilën kishte rënë në kontakt më herët se me atë sllave, para se të pushtoheshin tokat shqiptare, formën arvanit e shndërroi në arnaut, e jo siç mendojnë disa studiues si E. Çabej, O. Muderrizi, E. Sedaj e të tjerë, se ndryshimi i emrit etnik arban dhe arvan i shqiptarëve u bë me qëllim që të shkombëtarizohen më lehtë¹³², meqë formën e emrit shqiptar si shqipëtar së pari e shënon Milan Shuflai, që e kishte hasur në shkrimet mesjetare të shek. XIV te disa familje të krishtera shqiptare në Drisht¹³³ dhe në rrethinën e tij para depërtimit osman.

Edhe regjistrat kadastralë osmanë e dëshmojnë mendimin tonë se edhe pas islamizimit të individëve shqiptarë, atyre që dëshironin iu lejohej ta ruanin etnonimin, apo patronimin – emrin e babait apo të gjyshit, por ishte kusht që së paku ai që donte ta ruante pozitën shoqërore duhej ta merrte emrin mysliman, ndërsa mund ta mbante mbiemrin e krishterë të mëhershëm, si p.sh. Jusuf Gjoni, Hasan Gjini, Ali Barda, Hysein Barda¹³⁴, etj. dhe nuk ka kurrfarë dëshmish dokumentare se administrata osmane e bëri ndërrimin nga emri popullor arban në atë shqiptar.

Në burimet historike, sidomos në kronikat e autorëve antikë, jepen disa emërtime të vendbanimeve dhe antroponimeve të formuara me substratin arb, alb, por nganjëherë me metatezë, që gjendeshin në Ilirinë Jugore dhe Qendrore: Arbaios, mbishkrim i shek. III para Krishtit në Finiq¹³⁵; mandej qyteti Arban (Polibi shek. II, para Krishtit), qyteti Arba (G. Plini, shek. I, pas Krishtit); qyteti Albanopolis dhe popullsia albane (K. Ptolemeu, shek. II); popullsia Abroi (Arboi); qyteti Arbon dhe banorët e tij Arbonios dhe Arbonites (Stefan Bizantini, shek. IV).

¹³² Dr. E. Sedaj, *Etonimi – Arbëresh-Shqiptar*, Prishtinë, 1996, fq. 79-80.

¹³³ Milan Shuflai, *Serbët dhe shqiptarët... vep. e cit.*

¹³⁴ Tapu ve Kadastro Umum Müdürlüğün Arsivi, Defter-i mufassal-i Liva-i Prizren, nr. 55, BBAI, Defter-i Mufassal-i Liva-i Vliçitern, nr. 124.

¹³⁵ P. Cabanes, *L'Épire de la mort du Pyrhos à la conquête romaine (272-167)*, Paris, 1976, 572.

Këto të dhëna toponimike dhe antroponimike me bazën arban - me forma të ndryshme janë dhënë sipas Hekateut, shek. V para Krishtit dhe Polibit, qytete Arbërie (Anonimi i Ravenës, shek. VII-VIII¹³⁶).

Në studimin e tij K. Biçoku¹³⁷ shpreh mendimin se ndoshta emri i lumit Barbana (sot Buna), që e përmend vetëm T. Livi, ka si rrënjë bazën Arb.

Ndër faktorët e shumëfishtë që mundësuan përhapjen dhe shtrirjen e etnonimit Arban në Arbanonin e Sipërm, Arbanonin Qendror dhe në Arbanonin Jugor, ishin lidhjet e komunikacionit rrugor tregtar¹³⁸ nëpër të cilat zhvillohej tregtia e mallrave të ndryshëm e që kalonin nëpër tokat shqiptare mesjetare që lidhnin bregdetin me viset lindore:

- a) Raguza- Pazar i Ri-Zveçan (Mitrovicë)-Nish,
- b) Bregdet Kotor-Tivar-Breskocv (Plavë)-Pejë-Fushë-Kosovë-Nish, dhe
- c) Degëzimi Fushë-Kosovë-Shkup, Bregdet-Shkodër-Rrafshi i Dukagjinit -Fushë- Kosovë-Nish,
- d) Bregdet – Shufada - Lezhë-Fan – Prizren – Fushë- Kosovë, Fushë- Kosovë-Shkup dhe degëzimi Fushë-Kosovë-Nish.¹³⁹

Arbanonin Qendror e lidhnin dy rrugë tregtare shumë të rëndësishme:

- a) Bregdet Grykëderdhja e lumit Ishëm, Durrës-Shkalla e Tujanit-Bulqizë-Dibër, Tetovë-Shkup;
- b) Rruga Egnacia (Durrës – Ohër – Manastir – Selanik –Kos-tantinopolis), që ishte rruga më e rëndësishme nga të gjitha të tjerat dhe si e vetme që rrihej nga qerret. Ajo kishte degëzime të shumta që e lidhnin me sistemin e rrugëve të Arbanonit etnik Verior të Sipërm dhe të Arbanonit etnik Jugor të Poshtëm.¹⁴⁰

¹³⁶ Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë, Tiranë, 1965, 48, 67, 93, 268, 416, 417, 488.

¹³⁷ K. Biçoku, Viset etnike shqiptare në mesjetë dhe përhapja e emrit kombëtar Arbër (Arbëri-Albani), Studime historike, Nr. 1-4, Tiranë, 1992, f. 34.. O. Myderizi, Emni i Shqipnisë në kohën e mesme, Hylli i Dritës, v. 1943, Nr. 4-5, 131-133.

¹³⁸ J. Adami, Historia e rrugëve të Shqipërisë, Buletin për Shkenca Shoqërore, Tiranë, 1953, Nr. 3, 23-26.

¹³⁹ K. Biçoku, Rrugët nëpër Vilajetin e Krujës të shek. XV dhe lokalizimi i Shufadasë, Monumentet, Tiranë, 1982, Nr. 1, 41-62. A. Baçi, Rrugët shqiptare në mesjetë (shek. VII-XV), Monumentet, Tiranë, 1984, Nr. I, 58-68. V. Shtylla-L. Papajani, Të dhëna teknike mbi rrugët e Luginës së Shkumbinit në antikitet e mesjetë, Monumentet, Tiranë, 1991, Nr. I, 57-73.

¹⁴⁰ K. Biçoku, Idem. fq. 25-26.

Në Arbanonin etnik Jugor të Poshtëm kalonin disa rrugë:

- a) Bregdet (Grykëderdhjet e lumenjve Seman e Vjosë)-Berat-Fushë e Korçës-Kostur-Manastir- dhe degëzimi i dytë: Berat-Permet-Janinë,
- b) Rruga Vlorë-përgjatë Lumit Vjosë-Janinë,
- c) Rruga Butrint-Gjirokastër-Janinë,
- d) Rruga Artë-Janinë.¹⁴¹

Rruga më e mirë tregtare që kalonte nëpër viset e Arbanonit Verilindor dhe lidhte qendra të rëndësishme si Nishin, Shkupin-Manastirin, Kosturin-Janinë, etj. bashkë me rrugën Egnacia dhe me degëzimet e shumta të tyre duhet të kenë luajtur rol parësor në homogjenizimin e tipareve etno-kulturore të arbanëve mesjetarë dhe në përhapjen e emrit popullor mesjetar *Arbër-Arbëri-Albani*.¹⁴²

Shtrirja e viseve etnike arbane në një hapësirë gjeografike të gjerë në anën e Arbanonit etnik mesjetar Verilindor deri në Qustendil e Sofje, ku gjatë mesjetës arbanët jetonin me popuj të ndryshëm në kuadër të Perandorisë Bizantine dhe jashtë saj ndikoi ndjeshëm në përhapjen e etnonimit *arban* dhe në ndarjet e tyre etnografike, gjuhësore-dialektore, si dhe në jetën e tyre politike, administrative, kulturore e fetare. Sipas regjistrimeve kadastrale osmane të shek. XV-XVI për territoret e Bullgarisë Perëndimore, shihet qartë se në arealin e gjerë të hapësirës gjeografike Kumanovë-Shtip-Qustendil e deri në Sofje kishte vendbanime mesjetare me popullsi arbane, gjë që e dëshmojnë të dhënat toponimike dhe antropimike me bazë të gurrës shqipe.

Të dhënat e defterëve kadastralë osmanë si duket po e dëshmojnë tezën e historianit të njohur K. Jireček, i cili pohonte se Gryka e quajtur SUKI (*Klanac Succii*) – më vonë Porta e Trajanit (Trajanova Kapija) prej asaj kohe ishte kufi ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit; Thrakia ka qenë në kuadër të *praefectus praetorio Orientis*, ndërsa e tërë pjesa tjetër e Gadishullit deri në Danub e deri në brigjet jugore të Peloponezitet në kuadër të *praefectus praetorio Illyrici*¹⁴³, meqë, siç e theksuam më lart, na dalin vendbanime si enklava të banuara me popullsi shqiptare, duke filluar nga Sofja në drejtim të Qustendilit-Radomirit dhe Shtipit (Astibos-it), të cilat mbanin ende toponomi me bazën e gurrës shqipe, si p.sh. në rajonin e

¹⁴¹ K. Biçoku, Idem, fq. 25-27.

¹⁴² K. Biçoku, Idem, fq. 25-27.

¹⁴³ Th. Mommsen, Mémoire sur les provinces romaines jusqu'au V siècle, Revue archéol. 866. 1867. Zbornik Konstantina Jireceka, I, SAN, Posebna izdanja, Odelenje, društvenih nauka, Nova serija, libri 33, Beograd, 1959, f. 81-129.

qytetit antik Astibos të Dardanisë antike (Maqedonia e sotme), në Nekropolin e quajtur Suburbium, në një varrezë nga periudha e shek. III-IV të erës sonë, nga një grup arkeologësh maqedonas (V. Sanev, M. Ivanovski, Zh. Vinçiqi, dhe G. Spasovska-Dimitrioska) u identifikua varreza me mbishkrimin grek « ΦΛ(ΑΒΙΩ) ΑΛΒΑΝΩ ΤΩ ΤΕΚΝΩ Α ΜΙΛΙΑΝΟΣ ΑΛΒΑΝΟΕΣ ΜΝΗΜΕΗΣ ΝΑΕ » - (Flavio Albano, të birit të vet Emilianos Albanos për përkujtim).

Njoftimet e para për këtë varrezë si zbulim arkeologjik i publikoi Gordana Spasovska-Dimitrioska¹⁴⁴ arkeologe. Këtë mbishkrim të autores në fjalë e bëri të ditur në gjuhën shqipe studiuesi Qemal Murati.¹⁴⁵

Pas përmendjes së parë të fisit Albanoi nga ana e gjeografit Aleksandrian Klaudi Ptolemeu në shek. II të erës së re, kjo është dëshmia tjetër e dytë e shfaqjes së etnonimit albano, prandaj nuk ka dyshim se emri i albanëve antikë ka lidhje dhe vazhdimësi të pandërprerë deri në mesjetë, gjë që e dëshmojnë dymbëdhjetë (12) vendbanimet me etnonimin Arban¹⁴⁶, që përmenden në mesjetë, pikërisht në hapësirën Kumanovë-Astibos-Qustendil e Sofje, siç ishin: Arbanashka e Kumanovës¹⁴⁷, Arbanasi i Vrajës, Arbanasi me emrin tjetër Zhiganci i Shtipit, Arbanashi me emër tjetër Zubanci i Shtipit, Arbanashi i Epërm i Shtipit, Arbanashi i Poshtëm i Shtipit, Arbanashi i nahijes së Serishnikut në Maqedoninë e sotme Verilindore, Arbanashi i Radomirit, Arbanashi tjetër-trollishte i nahijes Radomir¹⁴⁸-Qustendil, Arbanashi i Sofjes dhe Arbanashi tjetër-trollishte i Sofjes¹⁴⁹, Arbanashi i shek. XIV i Tërnovës afër maleve Koxha Ballkan, që sot ende ekziston me këtë emër në Bullgari, dhe një toponim tjetër me formën greke Arvati (i shtrembëruar) nga Arvanitis¹⁵⁰, që nga viti 1330 (shek. XIV), e pastaj edhe gjatë shekujve XV-XVI haset në të njëjtat forma.

¹⁴⁴ G. Spasovska-Dimitrioska, Grobot na pisarot od Stobi, « Macedoniae acta archeologica » Nr. 14, Makedonsko Arheolosko Društvo, Skopje, 1996.

¹⁴⁵ Q. Murati, « Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve », Tetovë, 1999, fq. 31-32.

¹⁴⁶ Miodrag Purković, Popis sela u srednjovekovnoj Srbiji, vep. e cit. f. 4-8., BBAI, Defter-i Esami-ivojnuk, Nr. 21, shek. XV, Tapu ve Kadastro, Müdürlüğü Arsivi – (Kuyud-i kadime), Defteri Nr. 85, Ankara, shek. XVI, BBAI, Defter-i Liva-i Mufassal-i, Sofija, Nr. 130, BBAI Tapu Tahrir Defter-i, Nr. 236. BBAI, Maliye Defter-i Nr. 276, Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod, Opsirni popisni defteri od XVI vek, za Kustendislikiot sandzak, Tom V, Libri II, Shkup, 1980, fq. 216, 422, 582.

¹⁴⁷ Popis sela u srednjovekovnoj Srbiji, vep. e cit. f. 4-8.

¹⁴⁸ Tapu tahrir Defterleri, të përmendura si më lart, idem.

¹⁴⁹ Tapu tahrir Defterleri, të përmendura si më lart, idem.

¹⁵⁰ Tapu ve Kadastro, Müdürlüğü Arsivi, Nr. 85, Turski dokumenti, vep. e cit. f. 88.

Në hapësirën e Nishit, përkatësisht në rrethinën e Prokupjes, na del një toponim me formën Alban në deferët e shek. XV dhe atij XVI¹⁵¹, po me formën Alban, që në atë kohë kishte pasur 30 shtëpi.

Sot në anën e Toplicës ekziston një vendbanim me formën e shtrembëruar Alabana dhe mendojmë se i njëjti ka të bëjë me toponimin e mirëfilltë mesjetar Albanin. Duhet hulumtuar edhe burime të tjera perëndimore për ta vërtetuar se në cilën periudhë ai ka mundur të paraqitet me këtë trajtë për dallim nga toponimet e tjera që janë sajuar nga administrata sllave me trajtën Arbanas dhe Arbanashka, të cilat mendohet se i ka emërtuar administrata bullgare gjatë sundimit të saj në gjysmën e shek. IX dhe në fillim të shek. X.

Ekziston edhe një toponim tjetër me bazën e njëjtë me emrin Albince¹⁵², fshat baritor te Jakupica¹⁵³ në anën e Kërçovës, ku del të ruhet trajta arumune Albin, nga substrati i etnonimit Alban.

Sipas disa autorëve serbë, fshatrat e sotme Bregovinë dhe Sllavojevac në mesjetë janë quajtur me emrin Alban, mirëpo saktësisht nuk mund të konstatojmë se kur u është ndryshuar emri i tyre nga administrata sllave.

Përveç këtyre vendbanimeve në arealin e zënë ngojë, për të dëshmuar se banorët e tyre nuk ishin nomadë, por popullsi autoktone e mesjetës së hershme ndërmjet Sofjes dhe Qystendilit e Pirotit, kanë ekzistuar edhe vendbanimet e tjera mesjetare të bazuara në toponomastikën arbane, siç ishin Bardofc¹⁵⁴, Balsha¹⁵⁵, Gurmazova¹⁵⁶, Gurbanofci¹⁵⁷, Zgurova¹⁵⁸, Maleshofc¹⁵⁹, Mazaracë-eva¹⁶⁰ Ligator¹⁶¹, Prendi¹⁶², etj. (në hapësirën Sof-

¹⁵¹ BBAI, Rumeli timar defter-i nr. 167.

¹⁵² J. Cvijic, Osнова za geografiju i geologiju Makedonije, Beograd, 1906, I, fq. 138.

¹⁵³ Q. Murati, Shqiptarët dhe Ballkani ilirik, vep. e cit. fq. 40.

¹⁵⁴ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 236, fq. 585 dhe Defter-i nr. 130.

¹⁵⁵ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 236, fq. 585 dhe Defter-i nr. 130.

¹⁵⁶ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 236, fq. 585 dhe Defter-i nr. 130.

¹⁵⁷ Hauptman Gerba: Die Kaiserlichen in Albanien 1689, Mitteilungen des KK, Kriegs-Archives, Band. II, Wien, 1888, Übersich des Kriegsschauplatzes in alt-Serbien und Albanien, 1689, Wien, 1880, Gustav Hubka, Die Österreichisch-Ungarische-Offizieromission in Makedonien, 1903-1909, Wien, 1910..

¹⁵⁸ Idem – Hartat topografike,

¹⁵⁹ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 236, fq. 585. dhe Defter-i nr. 130, f. 491.

¹⁶⁰ Idem, hartat topografike,

¹⁶¹ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 236, fq. 196. dhe Defter-i nr. 130, f. 491.

je-Qystendil), Bardova¹⁶³ (në rrethin e Shtipit), Luleshofc¹⁶⁴, Barlofc¹⁶⁵, Maleva¹⁶⁶, Gjinofoç¹⁶⁷, Shpaj-a¹⁶⁸, Vava¹⁶⁹, Buzovik¹⁷⁰, Ligator¹⁷¹, Lumnic¹⁷² (në arealin e Pirotit).

Vendbanimet me etnonimin arbneshe janë shumë të vjetra që nga koha e Bizantit, të cilat më vonë i emërtoi administrata bullgare që nga mesjeta e hershme (shek. IX-X) dhe të njëjtat i trashëgoi administrata osmane me emërtime të formave sllave.

Për dallim nga 12 vendbanimet e tjera që na dalin në hapësirën Sofje – Qystendil – Shtip - Kumanovë, kemi 10 vendbanime të tjera në hapësirën tjetër gjeografike, që përmenden në regjistra dhe burime të tjera osmane të shek. XVI me formën turke Arnaut në pjesën lindore të maleve Rodope dhe në jug të Adrianopolisit (Edrenesë së sotme), janë krejtësisht vendbanime të tjera të krijuara gjatë dyndjes së popullsisë shqiptare.

Këtyre vendbanimeve administrata bullgare shumë vonë ua ndërroi emrat duke i zëvendësuar me ato bullgare, si p.sh. Arnaut¹⁷³; emri tjetër Poroishte i takon Hezargradit-Razgradit, i ndryshuar në vitin 1934; Arnautov emri tjetër Zagara i takon Eski Zagarës i ndryshuar në vitin 1934; Arnaut köy emri tjetër Dolina, i takon Hacıoglu Pazarcik-ut - Tolbuhinit i ndryshuar në vitin 1942; Arnaut köy me emrin tjetër Draganova i takon arealit të Burgazit i ndryshuar në vitin 1971; Arnaut köy emri tjetër Elshica i takon Filibes-Plovdiv-it i ndryshuar në vitin 1934; Arnaut köy emri tjetër Gugutka i takon Kërkhaliut (vend komune) i ndryshuar në vitin 1934; Arnaut köy emri tjetër Dolina İreçekovo i takon Jan Boluit i ndryshuar në vitin 1934. Këtij vendbanimi me etnonimin arnaut-shqiptar i është dhënë emri nga historiani i njohur çek Kostantin Jireçek në vitin 1934, i cili e kishte mbrojtur tezën e doktoranturës mbi historinë e bullgarëve në mesjetë; Arnautllar, me emrin tjetër Albancite, i takon Kërkhaliut i ndryshuar në vitin 1934; Arnautllar me emrin tjetër Make-donka i takon Hacıoglu Pazarcik-ut – Tolbuhinit i ndryshuar në vitin

¹⁶² BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 130, fq. 372.

¹⁶³ BBAI, Defter-i Esami-i Voynugan nr. 21.

¹⁶⁴ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 26.

¹⁶⁵ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 28.

¹⁶⁶ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 125.

¹⁶⁷ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 163.

¹⁶⁸ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 461.

¹⁶⁹ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 274.

¹⁷⁰ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 276.

¹⁷¹ BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 315.

¹⁷² BBAI, Tapu tahrir deftri, Defter-i Mufassal-i Liva-i, Sofja, nr. 82, fq. 322.

¹⁷³ M. Türker Acaroglu, ulgaristan'da Türkçe yer adları kilavuzu, Sevinç Matbaası, Ankara, 1988, fq. 71-72.

1942; Arnavutllar¹⁷⁴ me emrin tjetër Rudnik i takon Varnës i ndryshuar në vitin 1934.

Sa i përket vendbanimit me etnonimin Arbanas në Veliko Tërnovo që studiuesi turk M. Türker Acaroglu e përmend me emrin Arnavutlu dhe me emrin tjetër bullgar Paisov, duke mos e përdorur emrin e mirëfilltë të vjetër Arbanasi, nuk mund të pranohet se ky ishte i kohës së njëjtë nga shek. XVI, siç ishin ato 10 vendbanimet e tjera të emërtuara nga administrata osmane. Ky vendbanim ishte që nga shek. XIV i emërtuar me emrin Arbanasi, si edhe vendbanimet e tjera me etnonimin Arbanas në rrethinën e Radomirit, Qystendilit dhe Sofjes që ishin të regjistruara në Defterin osman të shek. XV.¹⁷⁵ Natyrisht se popullsia e tyre pas shek. XVI kishte marrë antroponimi thjesht sllave dhe gradualisht ishte asimiluar.

Nuk mund të qëndrojë teza e disa studiuesve të huaj dhe vendës se vendbanimet me etnonimin *Arbnesh* në arealin e Bullgarisë janë formuar nga shqiptarët e arratisur menjëherë pas vdekjes së Skënderbeut, siç mendon Kristo Frashëri¹⁷⁶ e disa të tjerë, meqë paraqitja e etnonimit *Arbnesh* të toponimizuar del në burimet sllave që në shek. XIII-XIV.

Sa u përket vendbanimeve të emërtuara me formën turke Arnavud (Arnaut), ndoshta ato janë themeluar pas arratisjes së shqiptarëve nga brendia e tokave shqiptare pas pushtimeve osmane në vende të tjera fqinje, siç është rasti me Bullgarinë. Kjo ngaqë janë regjistruar në defterët osmanë me trajtën turke Arnaut. Për këtë kanë shkruar disa studiues kur bëjnë fjalë për formimin e këtyre vendbanimeve gjatë shek. XVI në Bullgari, siç ishte Perikli Qili.¹⁷⁷ Administrata osmane emërvendet me etnonimin Arbnesh nuk i ka ndryshuar për arsye të çështjeve thjesht fiskale-financiare.

Në Defterin¹⁷⁸ kadastral të vakëfeve osmane nga shek. XVI, për arealin e Adrianopolisit (Edrenesë së sotme) përmenden edhe katër (4) vendbanime me etnonimin Arnavut¹⁷⁹ (Arnaut), ndërsa në trekëndshin ndërmjet Bullgarisë-Turqisë dhe Greqisë, duke përfshirë edhe malet Rodope, ekzistonin më se 50 vendbanime me emërtime të ndryshme greko-bullgare dhe turke në të cilat i hasim kryefamiljarët edhe me antroponime tradicionale shqiptare, por edhe me etnonimin e patronimizuar Arnaut.¹⁸⁰

¹⁷⁴ M. Türker Acaroglu, vep. e cit. fq. 72.

¹⁷⁵ BBAI, Tapu tahrir defteri Defter-i Esami-i Vojnugan Nr. 21, shek. XV.

¹⁷⁶ Kristo Frashëri, Trojet e shqiptarëve, vep. e cit., fq. 109-119.

¹⁷⁷ Mandrica, një fshat shqiptar në Bullgari, Studime filologjike nr. 3, Tiranë, 1967, fq. 197-198.

¹⁷⁸ BBAI, Defter-i Vilajet-i Edirne nr. 177.

¹⁷⁹ BBAI, Defter-i Vilajet-i Edirne nr.177, f. 51-52, 392-397.

¹⁸⁰ BBAI, Defter-i Vilajet-i Edirne nr.177, f. 1-800.

Është me rëndësi të madhe historike të theksohet se edhe sipas Defterit¹⁸¹ të vakëfeve të Sulltan Pajazitit dhe të Sulltan Mehmet Fatihut nga shek. XVI, në kazanë e Silivris-it, në rrethinën e Stambollit, janë regjistruar më se 35 vendbanime me emërtime greke dhe turke, në të cilat i hasim kryefamiljarët e regjistruar, ku dominonte kryesisht antroponimia tradicionale e krishterë shqiptare dhe ndër këto vendbanime janë regjistruar edhe shtatë (7) vendbanime me etnonimin e toponimizuar Arvanit (Arnaut): fshati Filipos Arvanit¹⁸² (Arnaut), Lagopetra¹⁸³, Arnavit Askenci¹⁸⁴, Arvanit Jelada-Helada¹⁸⁵, Arvaniti¹⁸⁶ tjetër (i pacilësuar), Tanas Progos¹⁸⁷ dhe Kistana Gjini.¹⁸⁸

Mendojmë se këto 35 vendbanime, përkatësisht popullata e tyre ka vazhdimësi që nga koha e sundimit bizantin në rrethinat e Konstantinopolisit-Stambollit të sotëm, meqë emrat e këtyre kryefamiljarëve janë të sferës së krishterë bizantine, por me format e shqipes.

Duke u bazuar në analizën e antroponimive të këtyre vendbanimeve, mund të nxjerrim përfundimin që dëshmon bindshëm se të gjithë kryefamiljarët e këtyre vendbanimeve ishin me prejardhje arbane të krishterë, por disa kryefamiljarë që kishin kaluar në fenë islame kishin marrë emra tipikë orientalë, duke e ruajtur në shumë raste patronimin *arnaut*, siç e hasim rastin e kryefamiljarit Iljas Arnauti, emri tjetër i të cilit kishte qenë Jorgi Janaki (Janaçi). Kjo tregon se në 50 vendbanimet në hapësirën e Vilajetit të Edrenesë, si edhe në 35 vendbanime të tjera të kazasë Silivris të rrethinës së Stambollit pjesa dërmuese e kryefamiljarëve mbanin emra tradicionale të krishterë shqiptarë.

¹⁸¹ BBAI, Defter-i Evkafi, Istanbul, nr. 541.

¹⁸² BBAI, Defter-i Evkafi, Istanbul, nr. 541, fq. 529-530.

¹⁸³ BBAI, Defter-i Evkafi, Istanbul, nr. 541, fq. 529-530.

¹⁸⁴ BBAI, Defter-i Evkafi, Istanbul, nr. 541, fq. 532.

¹⁸⁵ BBAI, Defter-i Evkafi, Istanbul, nr. 541, fq. 544.

¹⁸⁶ BBAI, Defter-i Evkafi, Istanbul, nr. 541, fq. 575.

¹⁸⁷ BBAI, Defter-i Evkafi, Istanbul, nr. 541, fq. 532.

¹⁸⁸ BBAI, Defter-i Evkafi, Istanbul, nr. 541, fq. 557-558.

Prof. Ilijaz Rexha

DISTRIBUTION OF MEDIEVAL SETTLEMENTS
BEARING ARBAN-ALBAN ETHNONYM

Summary

On the distribution of the Arban-Alban ethnonym, the name of the Albanian people and the place name Arbanon-Arvanon, or Albania, for the medieval period (11th-15th centuries) numerous articles and studies have been written from both foreign and Albanian authors.

Until the discovery of Ottoman sources, or of Ottoman cadastral registers respectively, a thesis supported by L. Thaloch, K. Jireček and M. Shufflay was widely accepted stressing that the medieval Arbanon as a political social formation stretched in a geographical aspect too at the quadrangle so-called Tivar-Prizren-Ohër-Vlorë, with certain ramifications further in the north of Prizren. However, according to recently discovered documents of the Ragusa Archives, and especially of Ottoman cadastral registers (from the 15th –16th centuries), it has been testified that the ethno linguistic and ethno-geographic Arbanon stretched beyond Prizren as well up to Nish (Naisus) and Shtip (Astibos), precisely to where the Albanian population and its settlements stretched.

This time, we are giving for a first time archival data of onomatopoeic and toponymic character proving that the Albanian medieval settlements stretched beyond Nish and Shtip, some facts that beat the thesis invented by Serb historians that allegedly up to the 17th century and the beginning of the 18th, there had been no Albanian population in the present-day space of Kosova, Macedonia and the Nish region.

